



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:272236

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05841079

AC-I-23-0190

Në ankesën e

Paditësi/ankuesi

O O fshati K Lipjan, të cilin e përfaqëson avokati B I Prishtinë.

Kundër

E paditura

NSH, "Magjistrala", të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit,**
Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1780 të datës 22 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 20 qershor 2024, me shumicë lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit aprovohet pjesërisht si e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-15-1780 i datës 22 mars 2023 dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN032-0062 i datës 31 maj 2013.**
- 3. Obligohet e paditura AKP, që paditësit O O në emër të kompensimit për paga të papaguara për periudhën shtator 2006**

–qershor 2007, t’i paguaj shumën prej 753.70 euro, në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj shumën prej 75.37 euro, dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208 euro, të gjitha sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

4. Pjesa tjetër e kërkesës së paditësit në shumë prej 146.30 euro, refuzohet si e pa bazuar.

5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 10 korrik 2013, paditësi, ish punëtor i NSH-së “Magjistrala” në Prishtinë e ka dorëzuar një ankesë të përbashkët me ankuesit tjerë, që të gjithë të përfaqësuar nga avokati B I kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të NSH “Magjistrala” në Prishtinë PRN032-0062 të datës 31 maj 2013 me të cilin kërkesa e paditësit për kompensim e pagave të papaguara për periudhën shtator 2006 -prill 2007, ishte pranuar në shumë prej 375.00 euro, ndërsa ishte refuzuar si e pa bazuar shuma prej 525.00 euro, nga NSH- “Magjistrala” në Prishtinë. Kjo ankesë e përbashkët në bazë të urdhrit të gjykatës është ndarë, andaj avokati i paditësit me datë 30 shtator 2015, e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe bënë ndarjen dhe plotësimin e ankesës, e cila regjistrohet me numrin C-IV.-15-1780. Paditësi në ankesë pohon se në NSH “Magjistrala” në Prishtinë ishte në marrëdhënie të përhershme pune dhe kishte dokumentacion të mjaftueshëm, që atij t’i paguhen pagat e pa paguara deri në ditën e privatizimit të NSH-së. Paditësi, konsideron se e paditura nuk e ka kontestuar faktin se paditësi ishte në marrëdhënie pune të rregullt dhe të përhershme në NSH “Magjistrala”. Për këtë ekziston dokumentacioni i mjaftueshëm, mirëpo përkundër kësaj është refuzuar kërkesa për pagesat e pagave, andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj ankesën e tij si të bazuar si dhe ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet e përfaqësimit.

Me 03 shkurt 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit që ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja ka shtuar se NSH Magjistrala ka hyrë në

procedurën e likuidimit me datën 13 prill 2007, pala paditëse pranë Autoritetit të Likuidimit me datën 12 korrik 2007, ka parashtruar një kërkesë përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 900.00 euro. Autoriteti i likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga pala paditëse në atë procedurë dhe me vendimin me numër PRN032-0062, kërkesën e parashtruar nga pala paditëse e ka aprovuar në shumën prej 375.00 euro, ndërsa shumën prej 525.00 euro, e ka refuzuar si të pa bazuar. Objekt i shqyrtimit në këtë çështje juridikë është ligjshmëria e vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe se pala paditëse nuk ka parashtruar prova që dëshmojnë se procesi i likuidimit ka qene i pa drejtë. Saktësisht paditësi nuk ka treguar se cila dispozitë ligjore nuk është respektuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar dhe ka ardhur në përfundim se kërkesa e palës paditëse në atë procedurë është pjesërisht e bazuar. Vlera e aprovuar nga ana e autoritetit të Likuidimit prej 375.00 euro përben vlerën neto të pagueshme ndaj paditësit pasi që pjesa e tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributet janë mbajtur në momentin e pagesës së vlerës 80% të pagës. E paditura përfundimisht i ka propozuar gjykatës se kërkesë padinë ta refuzojë si të pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit në përputhje me nenin 74.2 të Ligjit nr.06/L-086.

Më 22 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJSK-së me Aktgjykimin C-IV.-15-1780 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit, dhe e ka vërtetuar vendimin e AL të AKP-së PRN032-0062 të datës 31 maj 2013 si të drejt dhe të bazuar në ligj. Në arsyetim të aktgjyimit thuhet se gjykata ka shqyrtuar pretendimet dhe parashtrimet e palëve në procedurë dhe ka konstatuar se Ndërmarrja Shoqërore Magjistrala ka hyrë në procedurën e likuidimit më me datën 13 prill 2007, parashtruesi i ankesës ka parashtruar një kërkesë për kompensimin e shumes prej 900.00 euro. Autoriteti i likuidimit ka vërejtur se informatat edhe provat e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës kanë qenë të pa mjaftueshme për shqyrtimin e kërkesës andaj edhe i ka dërguar kërkesë parashtruesit për informata dhe dëshmi plotësuese. Autoriteti i Likuidimit në përputhje nëmmin 18 të Ligjit të AKP-së, ka kërkuar informacione nga Banka Ekonomike në lidhje me historikun e llogarisë së klientit për periudhën kohore janar 2006 deri në dhjetor 2007. Banka Ekomomikë ka dorëzuar pranë palës kundërshtarë informatat në lidhje me llogarinë bankare të klientit nga e cila ka rezultuar se i njëjti figuron vetëm në periudhat kohore janar 2006 deri në dhjetor 2007, dhe për të cilën periudhë ishte paguar në vlerën prej

80% të pagës. Andaj Autoriteti i Likuidimit me vendimin me numër PRN032-0062, të datës 31 maj 2013, kërkesën për kompensim të pagave në shumën prej 900.00 euro, e ka aprovuar pjesërisht ku parashtruesit të ankesës i ka njohur shumën prej 375.00 euro, ndërsa shumën prej 525.00 euro, e ka refuzuar. Shkalla e I-rë në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se pala paditëse ka pretenduar se ka qenë punëtor aktiv i ndërmarrjes dhe se kjo vërtetohet nga lista e pagave po ashtu edhe nga lista e 20%, ku është përfitues i kësaj shume. Në anën tjetër pala e paditur e ka kontestuar kërkesëpadinë duke theksuar se pala paditëse nuk ka qenë punëtor aktiv në ndërmarrje për periudhën kohore gjatë muajit mars 2006, deri në dhjetor 2007, dhe se ky fakt është vërtetuar nga përgjigja e marrë nga Banka Ekonomike. Shkalla e I-rë në arsyetim tutje ka theksuar se nga lista e punëtorëve që është hartuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me të cilën janë përfshirë punëtorët që kanë përfituar 20%, i privatizimit, nuk shërben për paditësin edhe si bazë juridike për të kërkuar edhe pagimin e pagave të pretenduara. Po ashtu ka vlerësuar se paditësi nuk ka ofruar dëshmi-prova materiale, të cilat do të dëshmonin se i njëjti gjatë periudhës kontestuese ka kryer detyrat e punës sipas përshtimit të vendit të punës e që do t'i shërbente si bazë juridike për të kërkuar pagimin e pagave të pretenduara.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se kompensimi i pagave është rregulluar në nenin 40 të Shtojcës të Ligjit për AKP, mbi prioritetet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 që parashihet "kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga gjykata apo agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuara në tri paga mujore bruto për person. Andaj pas shqyrtimit të provave të lëndes gjykata ka ardhur në përfundim se paditësi nuk ka parashtruar prova të cilat dëshmojnë se i njëjti ka qenë punëtor aktiv i ndërmarrjes për periudhën kontestuese. Andaj nisur nga parimi i barrës së provës në kuptim të dispozitës nenit 322.1 të LPK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se pala paditëse me provat e prezantuara nuk ka mundur që t'i argumentojë pretendimet e dhëna me ankesë.

Me 29 mars 2023, paditësi/ankuesi nëpërmjet përfaqësuesit dorëzoi në DHPGJS-së një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-1780, të datës 22 mars 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të miratohet ankesa, të anulohet vendimi i të paditurës PRN032-0063 i datës 31 maj 2013 dhe të miratohet në tersi kërkesa e tij për paga dhe të obligohet AKP që në emër të pagesës së pagave të pa paguara ti paguajë paditësit shumën e borxhit

kryesor prej 900.00 euro duke llogaritur edhe kumatën, si dhe shpenzimet e përfaqësimit. Padiësi/ankuesi në ankesën e parashtruar nëpërmjet përfaqësuesit ka theksuar se ai ishte i punësuar te Magjistratja e me saktësisht padiësit me datën 22 maj 2007 i ishte dërguar njoftimi i ndërprerjes së marrëdhënies së punës prandaj kjo nuk është fare kontestuese. Padiësi thekson se ka dëshmuar se ai ishte në marrëdhënie pune në periudhën janar 2006 deri në dhjetor 2007 dhe për këta muaj atij nuk i janë paguar pagat nga punëdhënësi e ka përfshirë edhe atë në listën e pagave, prandaj e paditura duhet të obligohet nga Gjykata që të përmbush këtë detyrim juridik të pa kontestueshëm. Padiësi e ka kundërshtuar konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS, e cila thekson se është e kuptueshme se për Bankën Ekonomikë pse nuk e ka një listë sepse marrëdhënia e punës dhe detyrimet ndërmarrjeve Shoqërore ndaj punëtorëve të tyre nuk verifikohen nga banka private edhe arkivi dhe dokumentacioni zyrtar i NSH-së dhe AKP-së ai që e vërteton gjendjen e detyrimeve nga marrëdhënia e punës së punëtorëve në ndërmarrje shoqërore. Padiësi/ankuesi thekson se Banka nuk është institucioni që i lëshon as i ruan- mban Listat e Pagave të punëtorëve, prandaj llogaritë bankare të padiësve dhe historiku i tyre dëshmon vetëm pagesat e bëra nga NSH-ja dhe nuk mund të ishte ndryshe sepse banka mban evidencën e pagesave të kryera, e jo evidencën e pagesave të pa kryera. Ka shtuar se njoftimi për ndërprerjen së punës i cili është dërguar padiësit nga AKM tash AKP është dëshmia se ai punonte dhe realizonte të ardhura nga ky punëdhënësi. Padiësi me këtë dëshmi e ka vërtetuar një fakt të pa kontestuar se ai ishte punëtor i NSH-së deri me datën 22 maj 2007, deri kur atij duhet të paguhen pagat e mbetura borxh dhe i cili borxh është njohur duke e përfshirë në listën e pagave. Po ashtu konsideron se e ka argumentuar mjaftueshëm me prova zyrtare se ai gjendet në listën e pagave të hartuara nga kontabiliteti i Njësisë së "Magjistrale" në Carralëvë dhe të nënshkruara nga personat e autorizuar ku shihet se padiësi O O është radhitur në numrin rendor 25, ndërsa në rubrikat tjera janë dhënë detaje tjera për orët e punës dhe pagën mujore. Po ashtu Listat e pagave në asnjë rrethanë nuk janë kontestuar nga e paditura sepse vetë e paditura është në njohuri se personat përgjegjës të cilët kanë llogaritur, përpiluar dhe nënshkruar këto lista kanë qenë personat kompetent. Padiësi ankesës në Shkallë të dytë të DHPGJS i ka bashkangjitur si provë; letër pezullimin e dt.22 maj 2007, Librezën e punës, formularin e kërkesës të paraqitur tek AL për pagat e papaguara, kërkesën për pagat e paguara drejtuara AKP, deklaratën nën betim të

Sh P dhe A K dhe një përmbledhje mujore të pagave të punëtorëve të NSH-së per periudhën shtator 2006 – qershor 2007.

Me 05 mars 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj kësaj ankese. Në këtë parashtrësë AKP-ja ka pohuar se argumentet e veta qartësisht i ka sqaruar në mbrojtjen në ankesë, andaj përsëritja e tyre do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet ndryshohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 12 korrik 2007, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të NSH "Magjistranja" (në likuidim), një kërkesë për kompensim të 10 pagave të pa paguara për periudhën shtator 2006 - qershor 2007, në shumë prej 900.00 euro. Autoriteti i Likuidimit paditësit i kishte pranuar shumen prej 375.00 euro 20% e pagës, për periudhën shtator 2006 - qershor 2007, për vlerën neto të pagueshëm ndaj paditësit, ndërsa pjesën tjetër të kërkesës për paga të papaguara në shumen prej 525.00 euro, e kishte refuzuar me arsyetimin se pjesa tjetër është pambushur, bazuar në historikun e llogaris se klientit në Bankën Ekonomike.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV.-15-1780 e ka refuzuar si të bazuar ankesa e paditësit, dhe e ka vërtetuar vendimin e AL të AKP-së PRN032-0062 të datës 31 maj 2013 si të drejtë dhe të bazuar në Ligj. Shkalla e I-rë në e ka

refuzuara kërkesën e paditësit për shkak të mungesë së dëshmi-prova materiale të prezantuara nga paditësi. Shkalla e I-rë ka konstatuar se kompensimi i pagave është rregulluar në nenin 40 të Shtojcës të Ligjit për AKP, mbi prioritetet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 që parashihet "kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga gjykata apo agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuara në tri paga mujore bruto për person. Shkalla e I-rë ka ardhur në përfundim se paditësi nuk ka parashtruar prova të cilat dëshmojnë se i njëjti ka qenë punëtor aktiv i ndërmarrjes për periudhën kontestuese. Andaj nisur nga parimi i barrës së provës në kuptim të dispozitës nën 322.1 të LPK-së, e ka refuzuara kërkesën e paditësit.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi ka parashtruar ankesë dhe tutje pretendon se atij i takojnë pagat e paguara në shumë prej 900.00 euro. Ankuesi me ankesë e kundërshton aktgjykimin e atakuar për shkak se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat i privatizimit të NSH. Ndërsa thekson se datë 22 maj 2007, e ka pranuar njoftimin nga AKP dhe me këtë njoftim është informuar se :shumat-pagat e pa paguara që u janë borxh do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit (pranimi i borxhit). Si provë me ankesë në Shkallë të II-të ka bashkangjitur; letër pezullimin e dt. 22 maj 2007, Librezën e punës, formularin e kërkesës të paraqitur tek AL për pagat e papaguara, kërkesën për pagat e paguara drejtuara AKP, deklaratën nën betim të Sh P dhe A K dhe një përmbledhje mujore të pagave të punëtorëve të NSH-së për periudhën shtator 2006 – qershor 2007.

Në këtë lëndë duhet vlerësuar nëse paditësi me provat e ofruara ka dëshmuar se atij i takojnë pagat e papaguara për periudhën e kërkuar për 10 paga të papaguara në shumë e përgjithshëm prej 900.00 euro.

Paditësi në ankesën e tij pretendon se atij i takojnë pagat e papaguar në shumën prej 900.00 euro, nga NSH "Magjistrala" (në likuidim). Është e vërtetë që paditësi parandë Shkallës së I-rë nuk kishte paraqitur listën e pagave të punëtorëve të N.Sh-së të papaguara, mirëpo tani paditësi kërkesës për paga tani në procedurë të ankesës ka bashkangjitur letër pezullimin e dt. 22 maj 2007, Librezën e punës, formularin e kërkesës të paraqitur tek AL për pagat e papaguara, kërkesën për pagat e paguara drejtuara AKP, deklaratën nën betim të Sh P dhe A K dhe një përmbledhje

mujore të pagave të punëtorëve të NSH-së për periudhën shtator 2006 – qershor 2007.

Kolegji i Apelit me qëllim të arritjes së drejtësisë në bazë të nenit 70 i LPDH i pranon provat e paraqitura para tij dhe pas vlerësimit të provave, të lartcekura vjen në përfundim se paditësi ka qenë punëtor deri në qershor të vitit 2007. Ky fakt vërtetohet me listën e pagave që i përket periudhës shtator 2006 - qershor 2007, e ku shihet se emri i paditësit figuron në numrin rendor 25 dhe se të ardhurat e tij ishin 75.37 euro në muaj për periudhën shtator 2006 - qershor 2007.

Po ashtu Kolegji i Apelit vlerëson se nga Libreza e punës, letër pezullimin e dt. 22 maj 2007, deklaratën nën betim të dhen nga Sh P dhe A K e vërtetohet fakti se paditësi kishte krijuar marrëdhënie punë në NSH "Magjistralia". Nga përmbledhja e mujore e pagave të punëtorëve të NSH "Magjistralia" të nënshkruara nga llogaritari dhe drejtori i NSH-së, vërtetohet se paditësi kishte paga mujore neto në lartës prej 75.37 euro, ku gjithsejtë paditësi për periudhën nga shtatori 2006- qershor 2007 kishte paga të papaguara në lartësi prej 753.70 euro ($75.37 \times 10 = 753.70$ €), andaj paditësit i njihet kjo shumë. Kërkesa tjetër përtej shumës së aprovuar e që është 146.30 euro refuzohet për shkak se nuk është mbështetur në prova në nevojshme materiale.

E paditura përveç perëndimeve nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën me prova mbështetëse se paditësit i ka paguara shumën e kërkuar, andaj në këtë aspekt perëndimet e saj të ngritura përmes mbrojtjes dhe përgjigjes në ankesë janë të pabazuara.

Në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, paditëses i njihet edhe e drejta në interes ligjor prej 10%, në shumë prej 75.37 , ndërsa në bazë të nenit 62.2 të LDHP-së, paditësit i njihet e drejta e kompensimit të shpenzimeve të Avokatit në shumë prej 208 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditësit është aprovuar pjesërisht si e bazuar, dhe është ndryshuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkalles së I-rë i DHPGJS dhe vendimi i AL.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksa gjyqësore

Kolegji i Apelit nuk cakton taksa gjyqësorë për ankuesin. Udhëzimi Administrativ Nr.01/2007 për unifikimin e taksave gjyqësore, në nenin 13.3, parasheh që punëtorët për pagat e papaguara lirohen nga pagimi i taksave gjyqësore për shumat e kërkesave deri në 1000 €. Lartësia e kërkesës së ankuesit ishte nën 1000 €, prandaj ankuesi lirohet nga taksa.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 20 qershor 2024

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
